



Republika e Kosovës
Republika Kosova -- Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0035074-14/26 dt. 29.06.2026

Mitrovicë



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 17, pika r, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 13, paragrafi 1, pika 1.4, dhe nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.18; të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.06.2026, me propozim të Kryetarit të Komunës; sjell këtë:

VENDIM

Për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive që kanë arritur rezultate gjatë vitit 2026

1. MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive që kanë arritur rezultate gjatë vitit 2026.
2. Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për të arriturat në masivizimin e sportit, pjesëmarrje aktive në garat zyrtare dhe afirmim të sportit në Komunë dhe Kosovë.
3. Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është si në vijim:
 - 3.1. Klubit të Basketbollit “Trepça”, i ndahen mjete financiare në shumë prej 30.000 (tridhjetëmijë) €;
 - 3.2. Klubit të Futbollit të Femrave “Mitrovica”, i ndahen mjete financiare në shumë prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) €;
 - 3.3. Klubit të Futbollit “Mitrovica”, i ndahen mjete financiare në shumë prej 10.000 (dhjetëmijë) €;
 - 3.4. Klubit të Basketbollit të Vajzave U21 “Trepça”, i ndahen mjete financiare në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €.
4. Mjetet e ndara me pikën 3 të këtij vendimi, sipas shumave të cekura, barten në xhirollogari të klubeve sportive nga kategoria buxhetore: subvencione dhe transfere të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit


Safet KAMBERI



Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- DBF-së
- DEZHTI-së